



BLERINA BANUSHI

PHD

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

PHD Blerina Banushi është lektore pranë Departamentit të Ekonomisë, Sipërmarrjes dhe Financës, në Universitetin Barleti si dhe mban pozicionin e kordinatores në Institutin për Kërkim dhe Zhvillim Barleti (BIRD).

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Financë dhe Menaxhim Financiar të Institucioneve Private dhe Publike; Menaxhim Risku dhe Performancë Institucionale

EMAIL

b.banushi@umb.edu.al

BIO

Ph.D. Blerina Banushi ka përfunduar me rezultate të shkëlqyera studimet e larta “Bachelor” në profilin “Bankë, Sigurime dhe Tregje Financiare” dhe “Master i Shkencave” në profilin “Menaxhim Ndërmjetësish Financiarë, Financë Ndërkombëtare dhe Menaxhim Risku” në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti “La Sapienza” i Romës, Itali.

Në vitin 2021, ajo ka fituar gradën shkencore “Doktor” në Financë nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

Prej vitit 2012 është e angazhuar si pedagoge në institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.

Banushi ka një kontribut të gjerë në fushën kërkimore-shkencore të pasqyruar në artikuj shkencorë me faktor impakti, botime dhe pjesëmarrje në konferenca brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrje në borde revistash shkencore apo serial botimesh shkencore (joperiodike) dhe bashkë-organizime të konferencave shkencore kombëtare.

Fokusi i saj i hulumtimit përqëndrohet kryesisht në çështjet financiare të tregjeve dhe institucioneve financiare, me fokus të veçantë në menaxhimin e riskut dhe performancës. Fusha të tjera kërkimore janë performanca e institucioneve publike, auditimi i performancës në sektorin publik dhe mirëqenia ekonomiko-shoqërore.

Ajo gjithashtu ka eksperiencë në sektorin privat, në fushën e menaxhimit të financave dhe burimeve njerëzore, si edhe në atë publik si eksperte e jashtme vlerësimi pranë ASCAL.

Zotëron dy gjuhë të huaja (italisht, anglisht).